



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

DRAFT RREGULLORE E BRENDSHME

PËR TRAJTIMIN E STUDENTËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË

UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 47 datë21/06/2021

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja për trajtimin e studentëve me aftësi të kufizuara në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës bazohet në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503 datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar” në Kodin e Etikës, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës si dhe në Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuar”.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për trajtimin e studentëve me aftësi të kufizuara dhe përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e tyre me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta studentë në kushte të barabarta me të tjerët.

b) përcaktimet për garantimin e studimeve të pavarura për të gjithë studentët me aftësi të kufizuara që zgjedhin të studiojnë në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe qëllim për të garantuar studimet në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët.

Neni 3

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim:

- a) Të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve me aftësi të kufizuara në UAMD për të mundësuar pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në studimet e ofruara nga UAMD, mbështetjen financiare për studimet e tyre si dhe të garantojë aksesin e këtyre studentëve në të gjitha, në organet vendimarrëse, aktivitetet studentore, ato kërkimore shkencore dhe gjithë aktivitetet e tjera të ofruara nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës nëpërmjet ndihmës dhe mbështetjes.
- b) Të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave përgjegjëse të UAMD-së në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara me qëllim mundësimin e pjesmarrjes së tyre të barabartë në veprimtaritë dhe shërbimet e UAMD.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore e shtrin fushën e zbatimit për të gjithë studentët me aftësi të kufizuara për kohën që ata ndjekin studimet në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe gjatë të gjithë periudhës që gëzojnë statusin e studentit pranë UAMD.

Neni 5 Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.
2. Pengesa nënkupton:
 - a) Pengesat sociale veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;
 - b) Pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat, studentët me dëmtime ndijore, veçanërisht ato dëmtime në shikim e dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur ose personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;
 - c) Pengesat infrastrukturore, përfshijnë ato në hapësirat e ambienteve të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.
3. “Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara” është çdo dallim, përjashtim kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen e pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët të të drejtave dhe lirive themelore të njohura në Kushtetutë dhe ligj.
4. “Mohim i përshtatjes së arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë pa vendosur një barrë të tepruar me qëllim garantimin që studentët me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe ushtrojnë në kushte të barabarta me të tjerët gjatë ndjekjes së studimeve në UAMD.
5. “Studentë me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale, ndijore, dëmtime të cilat në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në veprimtaritë e ushtruara në UAMD në kushte të barabarta me studentët e tjerë.
6. “Përfshirje” është pjesmarrja efikase dhe e barabartë e studentëve me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat dhe veprimtaritë e UAMD, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat pengojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta studentë.
7. “Përshtatje e arsyeshme” është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t’u garantuar studentëve me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 6

Detyrimet e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës

Personeli i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës ka detyrimin të:

- a) mosdiskriminonjë studentët me aftësi të kufizuara duke garantuar që të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar gjatë ndjekjes së studimeve në UAMD nisur nga dëmtimi që ata kanë;

- b) garantojë barazinë, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se studentët me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta.
- c) Garantojë autonominë e studentëve me aftësi të kufizuara dhe respektimin e privatësisë së vendimarrjes së studentëve me aftësi të kufizuara;
- d) të garantojë aksesueshmërinë nëpërmjet mënjanimin të pengesave të të gjitha llojeve;
- e) përfshirjen e studentëve me aftësi të kufizuar në mënyrë që të mundësohet pjesmarrja e duhur dhe e barabartë e tyre në të gjitha sferat e ushtrimit të veprimtarisë dhe aktivitetit të UAMD-së.

Neni 7

Vendimmarrja e mbështetur

Personeli i UAMD-së ka detyrimin të garantojë për studentët me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për ndihmë në vendimarrje të marrin mbështetjen e duhur. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht duke ju dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar si si mund të përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.

Neni 8

Financimi i aksesueshmërisë

Universiteti “Aleksandër Mosiu” Durrës parashikon dhe miraton fonde specifike dhe merr masa të nevojshme për sigurimin e fondeve financiare me qëllim mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukurore gjatë ofrimit të shërbimeve për studentët me aftësi të kufizuara.

Neni 9

Nënpunësi që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar

Është punonjësi i Universitetit i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e aftësisë së kufizuar dhe ka për detyrë të monitorojë që politikat dhe programet të hartohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për aksesueshmërinë, përfshirjen, duke siguruar mundësi të barabarta për studentët me aftësi të kufizuara.

Neni 10

Plani i masave

1. UAMD miraton me urdhër të titullarit sipas fushës së përgjegjësisë planin e masave për përshtatshmëri dhe për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në institucion me qëllim ofrimin e shërbimeve për studentët me aftësi të kufizuar.
2. Në planin e masave përfshihet detyrimi i UAMD për a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, pë të cilat nevojitet përshtatshmëria, b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë.
3. Një kopje e këtij plani pasi është miratuar nga titullari i dërgohet Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar. Marrja e masave për përshtatshmëri duhet të jetë në çdo rast pjesë e specifikimeve teknike si një nga kushtet e nevojshme të detyrueshme për t’u plotësuar në një proces prokurimi.
4. UAMD ka detyrimin që të planifikojë në mënyrë progresive procesin e përshtatjes në përputhje me dispozitat e këtij vendimi. .

5. UAMD ka detyrimin që brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.
6. Plani i masave dhe raportimet periodike /vjetore për realizimin e tyre publikohen nga institucioni në faqen zyrtare të internetit në UAMD dhe dërgohen gjithashtu edhe në ministrinë përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.

Neni 11

Përshtatshmëria në komunikimin on line të informacionit

UAMD merr masa progresive për zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë së studentëve me aftësi të kufizuar të intelektit duke ndërtuar dhe përshtatur në përputhje me nevojat e tyre çdo informacion në internet të parashikuar për ta apo për konsumim publik.

Neni 12

Godinat e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës

1. Të gjitha godinat e UAMD-së duhet të sigurojnë përdorimin dhe aksesueshmërinë e tyre edhe nga studentët persona me aftësi të kufizuara.
2. Strukturat e brendshme të godinave të UAMD-së duhet të plotsojnë karakteristikat për të cilat flitet në nenin 9,17,19 dhe strukturat e jashtme ato për të cilat flitet në nenin 12 të vendimit nr. 1503 datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara, zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat hapësirat dhe shërbimet publike”.
3. Në ndërtesat e UAMD duhet të garantohet një nivel i arritshmërisë në hapësirat e brendshme i tillë që mund të mundësojë shfrytëzimin e ndërtesës si nga publiku ashtu edhe nga personeli në shërbim sipas rregullave të dhëna në nenin 4 të pjesës së dytë të Rregullores të miratuar me VKM nr. 1503, datë 19.11.2008.
4. Mobilimi, mjetet ndihmëse didaktike dhe pajisjet e nevojshme për të siguruar zhvillimin e aktiviteteve didaktike duhet të kenë karakteristikat e veçanta për studentët persona me aftësi të kufizuara (banka, karrige, makina shkrimi, materiali Braille, dhoma zhveshje etj).
4. Në rastin e ndërtesave të Universitetit me shumë kate pa ashensor, klasa që frekuentohet nga ana e studentëve me aftësi të kufizuara duhet të jetë e vendosur në katin përdhe e arritshme nëpërmjet një kalimi të vazhdueshëm horizontal dhe me pjerrësi në pjesë të nevojshme të saj.
5. Të gjitha ndërtesat e UAMD-së duhet të respektojnë kërkesat e arritshmërisë të dhëna në pika 1, 2, 3 të nenit 4 të Rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara, zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat hapësirat dhe shërbimet publike”. Duke u kufizuar në shërbimet higjienike kërkesa do të quhej e plotësuar nëse të paktën një shërbim higjienik në çdo kat të përdorshëm është i arritshëm për studentët që janë në karrige me rrota. Nëse në ndërtesë në varësi të përmasave dhe të fluksit të studentëve dhe personelit që e përdorin duhen parashikuar më shumë grupe shërbimesh higjienike duhet gjithashtu që edhe ato të arritshmet nga persona në karrige me rrota të shtohen në proporcion.

Neni 13

Hapësirat e jashtme

1. Për hapësirat e jashtme që ju përkasin ndërtesave kushti i domosdoshëm i arritshmërisë quhet i plotësuar kur ekziston të paktën një rrugë për hyrje në ndërtesë e shfrytëzueshme edhe nga ana e personave me aftësi të kufizuar, përdorues të karrigeve me rrota dhe ndijues.
2. Rrugët në hapësirat e jashtme që të çojnë tek hyrja e ndërtesave të UAMD duhet të paktën një prej tyre të parashikohet me karakteristikat që lejon lëvizjet e personave me aftësi të kufizuara ose paaftësi lëvizëse dhe t'u garantojë atyre përdorimin e pajisjeve të parkimeve dhe të shërbimeve të vendosura jashtë ndërtesës.
3. Rrugët duhet të sigurojnë një ecje sa më të rehatshme dhe të lehtë për në hyrje të ndërtesës pa ngushtime, pajisje, pengesa të natyrave të ndryshme të cilat zvogëlojnë gjerësinë e kalimit ose mund t'i shkaktojnë dëmtime fizike përdoruesit të karriges me rrota. Madhësia e tyre duhet të garantojë lëvizshmërinë dhe në pika jo shmë të larta midis tyre edhe ndërrimin e drejtimit nga ana e një personi me karrige me rrota.

Neni 14

Rregullat kundër rënies së zjarrit

- Çdo zgjidhje e dhënë në projektin e godinave të UAMD-së për të garantuar mundësinë e hyrjes ose të shfrytëzimit duhet të parashikojë një shpërndarje të përshtatshme të ambienteve dhe përcaktimeve të veçanta teknike për mbrojtjen nga zjarri edhe të personave/ studentëve me aftësi të kufizuar ose paaftësi lëvizëse e ndijuese. Kështu duhet t'i jepet përparësi ku është teknikisht e mundur dhe në përputhje me rregullat në fuqi nënndarjes së tërësisë së ndërtesës në “dhoma kundër zjarrit” më tepër sesa “sistemeve të daljes” të përbëra nga shkallët e sigurisë që nuk mund të përdoren ga personat me aftësi të kufizuara ose paaftësi lëvizëse.
2. Ndarja në dhoma që përbëjnë “vendet e sigurta statike” duhet bërë në mënyrë të tillë që ambientet të jenë të mbrojtura të shpërndara njëtrajtësisht dhe në numër të mjaftueshëm të qëndrueshme ndaj zjarrit dhe lehtësisht të arritshme nga personat/studentët me aftësi të kufizuara ku më pas mund të presin ndihmën e shpejtë.

Neni 15

Përfitimet specifike të studentëve me aftësi të kufizuar

1. Përfitojnë trajtim financiar me bursë, studentët, cilët janë pranuar në programe studimi profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve të cilët ju përkasin shtresave sociale në nevojë dhe janë studentë me aftësi të kufizuara të vërtetuara nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të aftësisë për punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
2. Përfitohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët, të cilët janë pranuar në programe studimi profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve të cilët ju përkasin shtresave sociale në nevojë dhe janë studentë me aftësi të kufizuara të vërtetuara nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të aftësisë për punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
3. Paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve të miratuara nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës studentët që ndjekin studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve dhe janë studentë me aftësi të kufizuara të vërtetuara me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për punë.

Neni 16

1. Për përmbushjen e kriterit të përshtatshmërisë dhe aksesueshmërisë së godinave të UAMD-së konform kësaj rregulloreje dhe Rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara, zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat hapësirat dhe shërbimet publike”, ngarkohet Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve, Drejtoria e Administrimit Financiar si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të UAMD-së.

Neni 17**Miratimi dhe hyrja në fuqi**

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr. 47, datë 21/06/2021 të Senatit Akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.